



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Address: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 7 Tetor 2010
Ref. nr. AGJ 46/10

Aktgjykim

Rasti Nr. KO 80/10

Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e tij, Dr. Fatmir Sejdiu.

Baza juridike

2. Neni 84.9 dhe Neni 113.2.1, si dhe Neni 123 dhe Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

3. Presidenti i Republikës së Kosovës, përmes përfaqësuesve të vet ligjorë, paraqiti kërkesë pranë Gjykatës më 27 gusht 2010.
4. Më 31 gusht 2010, në pajtim me Rregulloren e punës, Kryetari i Gjykatës e caktoi Dr. Gjyljeta Mushkolajn si gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.
5. Më 1 shtator 2010, Sekretaria e Gjykatës, në pajtim me Rregulloren e punës, e njoftoi z. Qazim Qeska dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me këtë kërkesë dhe kërkoi përgjigjet e tyre.
6. Më 6 shtator 2010, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal e dorëzoi përgjigjen e tij në këtë kërkesë. Z. Qeska nuk u përgjigj.
7. Për shkak të natyrës së rastit, më 21 shtator 2010, Gjykata i dha përparësi këtij rasti.
8. Më 27 shtator 2010, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për pranueshmëri të kërkesës.
9. Gjykata në përbërje të plotë shqyrtoi dhe vendosi lidhur me këtë kërkesë në seancën e mbyllur që u mbajt më 27 shtator 2010.

Çështja e lëndës

10. Çështje e lëndës është pyetja në vijim që Presidenti i Republikës së Kosovës ia ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese:

"Cili institucion i Republikës së Kosovës është përgjegjës për të vlerësuar efektshmërinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe për të konstatuar përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune në bazë të një komunikate drejtuar qytetarëve, paqartësia e të cilës ia bën të pamundur Presidentit veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta?"

Pranueshmëria e kërkesës

11. Në pajtim me Nenin 113 (1) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka kompetenca të vendosë vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
12. Parashtruesi i kërkesës pohon që rasti aktual përfshin paqartësi lidhur me kompetencat e institucioneve përkatëse për ta përcaktuar validitetin e dorëheqjes dhe përfundimin e mandatit të kryetarit të një komune në bazë të një komunikate për dorëheqje drejtuar qytetarëve të komunës. Parashtruesi i kërkesës më tutje thekson që për shkak të këtyre paqartësive, Presidenti nuk mund të vazhonte

me veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta, të paraparë në Nenin 123 (2) të Kushtetutës lidhur me zgjedhjet komunale.

13. Parashtruesi i kërkesës konkludon që pasi "Presidenti është palë e autorizuar sipas Nenit 113, dhe çështja në fjalë ia ka bërë të pamundur Presidentit të ndërmarrë hapat e duhur për të siguruar pajtueshmëri me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta, Gjykata ka kompetencë për ta shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga Presidenti".
14. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës pohon që kriteret e përcaktuara në Nenin 84.9 dhe në Nenin 113.1.2 të Kushtetutës janë plotësuar në rastin aktual.
15. Neni 84.9 i Kushtetutës thotë me sa vijon:

"Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës...

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese...."

16. Është e qartë se në përputhje me Nenin 84(9) të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës është i autorizuar të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.
17. Prandaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse çështja e ngritur është "çështje kushtetuese" në pajtim me Nenin 84(9) të Kushtetutës.
18. Për shqyrtim të mirëfilltë nevojitet të përmbliidhen rrethanat faktike të çështjes të cilat shkaktuan që rasti të ngrihej para Gjykatës Kushtetuese.

Përmbledhje e fakteve lidhur me çështjen në fjalë

19. Më 1 korrik 2010, z. Qazim Qeska, kryetar i Rahovecit, publikisht iu drejtua qytetarëve të komunës së Rahovecit, përmes një komunikate, dhe njoftoi për dorëheqjen e tij të parevokueshme. Në dorëheqjen e tij të parevokueshme, z. Qeska theksoi se "kishte marrë vendim të prerë, vendim të menduar mirë, që ta përfundonte para kohe mandatin e dhënë ... nga populli me vullnetin e lirë konform Nenit 56, pika C të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale".
20. Ai gjithashtu tha: "Qytetarë të nderuar, është ky vendim i dhimbshëm por konsideroj thellë nga zemra dhe shpirti se është vendim më i drejtë dhe më i mirë, në interes të qytetarëve, ngase konstelacioni çfarë mbretëron te unë, përfshirë këtu edhe gjendjen time shëndetësore pamundëson që si kryetar i komunës ta kryej punën me përgjegjësi ndaj qytetarëve të komunës të Rahovecit ndaj të cilëve isha zotuar shumë thellë dhe me sinjeritet të madh. Arsyerat për dorëheqjen dhe përfundimin e mandatit para kohe janë kryesisht të natyrës personale. Vendimi është marrë me vendosshmëri dhe përgjegjësi më të madhe duke pas parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat personale (shëndeti i lënduar) si dhe interesin e qytetarëve të komunës së Rahovecit ndaj të cilëve kam qenë, jam

dhe do të jem gjithmonë korrekt e jo zhgënjyes. Qytetarë të nderuar, mandati është i popullit – është i juaji, andaj sot më 01 korrik të vitit 2010, mandatin tim që ju ma besuat ua kthej juve dhe vetëm juve, me shpresë se do të mirëkuptohem nga ju ngase ky vendim është më i qëlluar dhe më meritori. Populli im – qytetarët e komunës së Rahovecit meritojnë udhëheqës i cili do të jetë gjithmonë pranë tyre dhe me ta, por unë aktualisht nuk jam në gjendje për arsyerat të shumta të qëndrojë ballë qytetarëve ashtu siç jeni mësuar me mua. Kërkoj mirëkuptim të thellë për aktin tim të dorëheqjes dhe përfundim të mandatit para kohe.”

21. Më 6 korrik 2010, ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme MAPL) iu drejtua kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska, me një kërkesë për konfirmimin e dorëheqjes së tij nga posti i kryetarit.
22. Z. Qazim Qeska ia konfirmoi MAPL-së dorëheqjen e tij dhe bashkëngjiti komunikatën me shkrim të 1 korrikut 2010.
23. Më 16 korrik 2010, ministri i MAPL-së i dërgoi letër Presidentit të Republikës së Kosovës, me të cilën e njoftonte se z. Qazim Qeska e kishte konfirmuar dorëheqjen e tij të parevokueshme dhe se në bazë të Nenit 56.3, pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, “kryetarit të kësaj komune i ka përfunduar mandati.”
24. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese t’i vlerësojë faktet e këtij rasti të veçantë, por faktet e sipërpërmendura duken që në fillim ta ngrenë një çështje kushtetuese. Kjo në veçanti pasi ka të bëjë me dy dispozita kushtetuese: me Nenin 123 [Parimet e Përgjithshme të Qeverisjes Lokale dhe Organizimit Territorial], dhe me Nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.
25. Si rrjedhojë, në bazë të Nenit 84.9 të Kushtetutës, Gjykata konstatoi që kërkesa e parashtruar më 27 gusht 2010 nga Presidenti i Republikës është e pranueshme.
26. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë, nuk ka nevojë që Gjykata ta elaborojë bazën për pranueshmëri të paraparë me Nenin 113.1.2 të Kushtetutës.

Çështja substantive

27. Gjykata vëren se pjesa e parë e pyetjes së parashtruar nga Presidenti, e cila thotë: “*Cili institucion i Republikës së Kosovës është përgjegjës për të vlerësuar efektshmërinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe për të konstatuar përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune në bazë të një komunikate drejtuar qytetarëve...*” pyet nëse dorëheqja e cilitdo kryetar komune është përfundimtare dhe definitive dhe nëse i jep fund mandatit të kryetarit.
28. Parimet e Përgjithshme të Qeverisjes Lokale dhe Organizimit Territorial në Republikën e Kosovës janë të definuara në Nenin 123 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.

Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.

Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

29. Gjykata Kushtetuese rikujton që autoritetet lokale janë një prej themeleve kryesore të cilitdo regjim demokratik. Gjithashtu duhet të rikujtohet se për ta respektuar në tërësi Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duhet të sigurohet që autoritetet lokale posedojnë shkallë të gjerë të autonomisë lidhur me përgjegjësitë e tyre, mënyrat dhe mjetet me të cilat ato përgjegjësi ushtrohen dhe burimet që nevojiten për përmbushjen e tyre (shih Preambulën e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale).
30. E drejta kushtetuese për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës rregullohet më tej me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji 2008/03-L040 i miratuar më 20 shkurt 2008 dhe i shpallur më 15 qershor 2008).
31. Neni 56 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale e rregullon çështjen e zgjedhjes së kryetarit dhe përfundimin e mandatit të tij/saj, i cili thotë:

“Zgjedhja e kryetarit të komunës

56.1 Kryetari i komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale.

56.2 Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare.

56.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon:

- a) kur ta kryejë mandatin e tij;*
- b) nëse vdes;*
- c) nëse jep dorëheqje;...”*

32. Gjykata rikujton që Neni 8 i Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale e rregullon mbikëqyrjen administrative të veprimtarive të organeve lokale. Ai parashikon që cilado mbikëqyrje e veprimtarive të organeve lokale do të ketë bazë juridike dhe se cilado mbikëqyrje administrative do të jetë e kufizuar për të siguruar pajtim me ligjin vendës dhe me parimet kushtetuese.

33. Gjykata vëren se, në pajtim me Kushtetutën dhe me Nenin 8 të Kartës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk i fuqizon organet e qeverisë qendrore për të ndërmarrë masa për pranimin e dorëheqjes së kryetarit të komunës.
34. Për më tepër, për t'iu përgjigjur drejt çështjes në fjalë, duhet të rikujtojmë gjithashtu që Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (2008/03-L072 i miratuar më 5 qershor 2008 dhe i shpallur më 15 qershor 2008) e përshkruan përfundimin e mandatit të kryetarit të komunës në Nenin 11, i cili thotë:

“Neni 11

Përfundimi i mandatit dhe shkarkimi i kryetarit të komunës

11.1 Mandati i kryetarit të komunës përfundon në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

11.2 Kryetari mandati i të cilit përfundon në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni zëvendësohet përmes mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në atë komunë. Mandati i kryetarit të porsazgjedhur përfundon në datën e njëjtë sikurse mandati i kryetarit që ai/ajo e zëvendëson.”

35. Duke iu përgjigjur çështjes së sipërpërmendur kushtetuese, duke marrë parasysh dispozitat e sipërpërmendura të Kushtetutës dhe të ligjit të zbatueshëm, Gjykata Kushtetuese konstaton që dorëheqja e kryetarit të një komune është përfundimtare dhe definitive dhe i jep fund mandatit të kryetarit të komunës.
36. Gjykata gjithashtu duhet t'i marrë parasysh edhe pasojat kushtetuese të dorëheqjes së kryetarit të një komune.
37. Gjykata rikujton që e drejta e vetëqeverisjes mund të ushtrohet vetëm nga autoritetet e zgjedhura në mënyrë demokratike. Në këtë drejtim, është me rëndësi të kihet parasysh që Neni 3 (2) i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në pjesën përkatëse thotë me sa vijon:

“Neni 3 – Koncepti i vetëqeverisjes lokale

2. Kjo e drejtë do të ushtrohet nga këshillat ose kuvendet e përbëra nga anëtarët e zgjedhur në mënyrë të lirë me votim të fshehtë në bazë të votimit të drejtpërdrejtë, të barabartë dhe të përgjithshëm dhe të cilat mund të posedojnë organe ekzekutive që u japin llogari atyre....”

38. Gjykata gjithashtu dëshiron të rikujtojë që në përputhje me Nenin 123 (2) të Kushtetutës, e drejta për vetëqeverisje lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
39. Kjo e drejtë duhet të lexohet në lidhje me Nenin 45 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike.”

40. Gjykata Kushtetuese rikujton që Ligji për Zgjedhjet Lokale i jep kompetencë Presidentit të Republikës që t'i caktojë dhe shpallë zgjedhjet lokale.

41. Si rrjedhojë, duke pasur parasysh Nenin 123 (2) dhe Nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 3(2) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Gjykata konstaton që pasojat kushtetuese të veprimit të tillë janë shpallja e zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës për të siguruar që qytetarët gëzojnë të drejtën për zgjedhje të lira dhe të barabarta në themelimin e vetëqeverisjes së tyre lokale.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI VENDOS ME SA VIJON:

- I. Kërkesa është e pranueshme.
- II. Dorëheqja e cilitdo kryetar komune është përfundimtare dhe definitive dhe i jep fund mandatit të kryetarit të komunës.
- III. Pasojat kushtetuese të veprimit të tillë janë shpallja e zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës për të siguruar që qytetarët gëzojnë të drejtën për zgjedhje të lira dhe të barabarta në themelimin e vetëqeverisjes së tyre lokale.
- IV. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani